



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.750/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada Gllgjani dhe Adnan Konushevci anëtar, duke vendosur lidhur me apelin e paraqitur nga Shqiprim Selimi nga Shtimja, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Për Bashkim (LV), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021 të datës 03.11.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin e apeluar, për Zgjedhjet Lokale, të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.750/2021 i datës 03.11.2021, i ushtruar nga Shqiprim Selimi nga Shtimja, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Për Bashim (LV), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 2948-2021 të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 2206E/04D.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatin për anëtar të Kuvendit Komunal të Shtimes, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Për Bashim (LV), Komuna Shtime, në Vendvotimin: 2206E/04D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 03.11.2021, ka pranuar apelin Anr.750/2021, të ushtruar nga Shqiprim Selimi nga Shtimja, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Për Bashim (LV), me të cilin pretendon se në vendvotimin me numër 2206E/04D, ku ka votuar së bashku me prindin e tij në atë vendvotim ka 0 vota. Më tutje pretendon se edhe në FRP figurojnë 0 vota, kërkon nga PZAP që ti rinumërohen fletëvotimet në vendvotimin numër 2206E/04D.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Lëvizja Për Bashkim (LV), Shqiprim Selimi, kërkon korrigjimin e votave në vendvotimin 2206E/04D. PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Shqiprim Selimi Kandidat për Kuvend Komunal nga Lëvizja Për Bashkim (LV), me të cilin apel kërkon që ti korrigjohen votat në vendvotimin e lartcekur ku ka votuar vet dhe prindi i tij.

Paneli vlerëson se apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidati, ku shihet qarte se në qendrën e votimit 2206E/04D, ku ka votuar vet kandidati dhe prindi i tij, në FRK nuk figuron as një votë, andaj ky panel, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitim e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura, si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 750/2021 më datën 05.11.2021.

Kryesor i Panelit
Ferri Xhaferi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.